

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Mr.sc.Muhamet Rexha dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit H. P., nga Mitrovica, të cilin e përfaqëson Z. M., avokat nga Mitrovica, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës – Ministria për Punë të Brendshme, të cilën e përfaqëson Nazmije Aliu, nga Avokatura Shtetërore, për shkak të anulimit të vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.2540/2017 datë 9.1.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 28.5.2018, merr këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.2540/2017 datë 9.1.2018.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.2540/2017 datë 9.1.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C. nr.722/13 datë 27.1.2014, me të cilin me pjesën I të dispozitivit janë anuluar si të kundërligjshme: vendimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme i datës 22.3.2011 dhe vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës i datës 25.2.2011 me të cilin paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Me pjesën II të dispozitivit është obliguar e paditura Ministria e Punëve të Brendshme që brenda afatit 7 ditor ta kthej paditësin në punë në pozitën e njëjtë apo të ngjashme që i përgjigjet kualifikimeve dhe aftësive profesionale t'ia paguajë të gjitha pagat, ku paga bazë mujore ka qenë 215.33 €, si dhe shtesat tjera që i kanë takuar në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, përfshirë që nga muaji mars i vitit 2011 e deri sa paditësi të kthehet në punë, dhe atë me kamatë sikurse për mjetet e deponuara në bankë për periudhën një vjeçare pa destinim të caktuar. Me pjesën III të dispozitivit është

obliguar e paditura Ministria e Punëve të Brendshme që t'ia paguaj paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës shumën prej 336.96 €, të gjykuar sipas aktgjykimit C.nr. 01/2012, si dhe shumën prej 101.40 € në emër të përgjigjes në ankesë dhe shumën prej 270.40 euro në emër të dy përfaqësimeve nga 135.20 €, ndërsa gjykatës në emër të shpenzimeve gjyqësore shumën prej 50 €, të gjitha këto në fat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbartimit të detyrueshëm.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të anulohen konform dispozitës ligjore nga neni 224 par. 2 të LPK –ës.

Paditësi me përgjigjen në revizion, ka propozuar që revizioni të refuzohet si i pabazuar, ndërsa aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të vërtetohen.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune të e paditura – zyrtar Policor, nga data 29.11.1999. Me aktvendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë nr. ..., datë ..., paditësit i është shqiptuar masa disiplinore – ndërprerja e marrëdhënies së punës, për shkak të shkeljes së nenit 46 të Ligjit për Policinë dhe nenit 5 par. 12 të Udhëzimit administrativ 15/2008 – MPB. Me vendimin nr. 274 datë 23.3.2011 të Ministrit të MPB është hedhë poshtë ankesa e paditësit paraqitur kundër vendimit të cekur më lartë, pas së cilës paditësi ka paraqitur padi në gjykatë.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë ka konkluduar se e paditura ka bërë shkelje të nenit 15 të Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2008, e cila parasheh se procedura disiplinore duhet të përfundojë brenda afatit prej 60 ditëve, por ka mundur të zgjatet edhe për një periudhë prej 30

ditëve shtesë por që duhet të arsyetohet për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, ndërsa në rastin konkret kanë kaluar më tepër se 4 muaj hetim disiplinor, dhe duke vlerësuar se vendimet e të paditurës bazohen në një procedurë disiplinore me shkelje procedurale në aspektin e afateve kohore për kryerjen e saj, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore në tërësi i ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se konkludimi i gjykatës së shkallës së parë se ka arritur parashkrimi i procedurës disiplinore është i drejt dhe i bazuar në ligj, pastaj ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e të paditurës, ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e ankimuar.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Masa disiplinore e pushimit të marrëdhënies së punës mund t'i shqiptohet të punësuarit sipas procedurës, në mënyrën dhe kushtet e parashikuara me ligj, aktin normativ të punëdhënësit mbi marrëdhëniet e punës, përkatësisht përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të të punësuarve. Sipas nenit 15 par. 1 të Udhëzimit Administrativ nr. 10/2008 të MPB, për Themelimin e Komisionit për Emërime të Larta dhe Disiplinë në Polici, çështja disiplinore përfundon brenda një periudhe kohore prej 60 ditësh, nga dita e paraqitjes së kërkesës nga Inspektorati Policor, me përjashtim të rasteve kur shtyrja bëhet e detyrueshme për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, ndërsa në rastin konkret procedura disiplinore është iniciuar më 29.7.2010 dhe ka përfunduar më 2.12.2010, që përbën me tepër se 4 muaj. Andaj, edhe Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se shqiptimi i masës disiplinore të pushimit të marrëdhënies së punës është marrë me shkeljen e procedurës së paraparë me dispozitat e sipër përmendura nga ana e të paditurës e cila në aktet e saj ligjore ka paraparë rregullat dhe afatet e shqiptimit të masës disiplinore, të cilat e obligojnë të paditurën t'u përmbahet, për të cilën arsye vendimi i të

paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është i paligjshëm, dhe me të drejt është anuluar nga gjykatat e instancës më të ulët.

Pretendimin e cekur në revizion, se aktgjykimi i kundërshtuar është marrë në bazë të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, sepse dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, ngase në revizion nuk theksohet asnjë rrethanë se në cilën pjesë të aktgjykimit dispozitivi është në kundërshtim me arsyetimin. Faktin e cekur se në veprimet e paditësit ekzistojnë elementet e shkeljes së rëndë të detyrave të punës dhe gjykata nuk ka marrë parasysh deklaratat e të paditurës, kjo Gjykatë i shqyrtojë, por të njëjtat nuk ndikuan që të vendoset ndryshe, ngase në rastin konkret qenësorë ka qenë koha e zhvillimit të masës disiplinore e cila nuk është zbatuar konform Urdhëresës Administrative të paditurës e cila është cekur më lartë.

Gjykata Supreme e Kosovës i shqyrtoi të thënat e revizionit se më datë 26.2.2010 rreth orës 10,45, deri sa paditësi ka qenë në detyrë me veturën zyrtare Golf 5 me targa të regjistrimit ..., ka shkuar në të ashtuquajturën komunë paralele serbe për të aplikuar për letërnjoftimin e tij personal, duke vepruar kështu në kundërshtim me Ligjin për Policinë, por këto pretendime kanë të bëjmë me vërtetimin e gjendjes faktike, për të cilën në bazë të nenit 214 par.2 të LPK –ës revizioni nuk mund të paraqitet. Kjo Gjykatë shton se këto pretendime të paditurës të cekura në revizion janë përsëritje gjatë procedurës para gjykatave të instancës më të ulët për të cilat ato gjykata kanë dhënë arsye të mjaftueshme.

Nga sa u tha më lart, e me zbatimin e nenit 222 të LPK -ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Më 28.5.2018, Rev.nr.139/2018

Kryetarja e kolegjit,
Emine Kaçiku